



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:003360
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05502709
C.nr.10/2020

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departamenti i përgjithshëm-Divzioni civil, gjyqtari Riza Livoreka, gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: Sh. L. , S. I. e lindur L., I. L. , S. Z. e vajzërisë L., A. L. , Z. Z. e lindur L., A. L. , A. B. dhe H. E. e lindur L., të cilin me autorizim i përfaqëson D. R. avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurës K. K. , të cilin me autorizim e përfaqëson I. L., për çështjen kontestuese vërtetimi i pronësisë, në seancën kryesor të datës 04.03.2024, në praninë e të autorizuarit të paditësve dhe të autorizuarit të paditurit, ndërsa me datën 26.03.2024, bëri përpilimin me shkrim të këti:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Sh. L. , S. I. e lindur L., I. L. , S. Z. e vajzërisë L., A. L. , Z. Z. e lindur L., A. L. , A. B. dhe H. E. e lindur L., të gjithë nga Kaçaniku dhe **VËRTETOHET** se paditësit janë bashkëpronar, me nga 1/9, e pjesës ideale, të një pjese të njësisë kadastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë male , i klasës 4, në sipërfaqe prej 300m², Zona Kadastrale Kaçanik, e cila përkufizohet siç vijon:

-Në anën perëndimore, nga pika 1 deri tek pika 2, në gjatësi prej 13.37 m, në anën veriore, nga pika 2 deri tek pika 3, në gjatësi prej 20m, në anën Lindore, prej pikës 3 deri tek pika 4, në gjatësi prej 14,80m, dhe në anën jugore, me rrugën publike, nga pika 5 deri tek pika 6, në gjatësi prej 11.40, dhe prej pikës 6 deri tek pika 1, në gjatësi prej 6.19m.

Pjesë përbërëse këtij aktgjykimi, është skica e ekspertit të gjeodezisë, me kordinata e pikave të terrenit.

II. DETYROHET, K. K. -Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër qe ta bëj regjistrimin në Regjistrat e Palujtshmërive, në bazë të këtij aktgjykimi, i cili ka titull ekzekutiv.

III.DETYROHET e paditura që paditësve, t'ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 987.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësit, për mes të autorizuarit, si me padi ashtu në seancat mbajtura, kanë kërkuar nga gjykata, qe kërkesëpadinë e paditësve, ta miratoj në tersi si të bazuar dhe ta vërtetoj se paditësit janë bashkëpronar, me nga 1/9, e pjesës ideale, të një pjese të njësisë kadastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë male, i klasës 4, në sipërfaqe prej 300m², Zona Kadastrale Kaçanik.

I autorizuari ka theksuar, se paditësit janë pasardhës të ndjerit E. L. , nga Kaçaniku, të cilit deri sa ishte në jetë, me aktvendimin mbi dhënien e tokës në shfrytëzim të përhershëm Nr. 04-4306/1-70, i datës 26,12,1970, nga Drejtoria për Financa –shërbimi Juridiko pronësorë, në Kaçanik , i është ndarë toka ndërtimore në sipërfaqe prej 300m², nga pk.nr.45/1, e evidentuar në fletën e posedimit 379 , për ndërtimin e shtëpisë familjare.

Paraardhësi i paditësve, ka vepruar sipas këtij aktvendimi, të datës 26.12.1970, në afatin e caktuar në palujtëshmërin e cekur, e ka ndërtuar shtëpinë banimit, sipas vendimit mbi dhënën e lejes për ndërtim 04-Nr.351-20-73, i datës 08.08.1973, i lëshuar nga e paditura.

Tutje ka theksuar, nga ekspertiza gjeodezike, është përcaktuar saktë sipërfaqja ,si dhe shtëpia e ndërtuar, e cila është ndërtuar në palujtëshmërin , të cilën e paditura me aktvendimin nr.04-4306/1-70, të datës 26.12.970, paraardhësit të paditësit i është ndarë toka ndërtimore në sipërfaqe prej 300 m², pastaj i njëjti e ka ndërtuar shtëpinë e banimit , në të cilën ka jetuar , e ka paguar tatimin në pronë dhe obligimet tjera komunale.

Po ashtu ka sqaruar, se kjo palujtëshmëri, ju ka ndarë, pa të drejtë tjetërsim dhe paraardhësi i paditësve, këtë të drejt nuk e ka tjetërsuar tek personat e tretë, por e njëjta është përcjell tek pasardhësit e tij. Prandaj duke e pasur parasysh se kanë kaluar afërsisht 50 vjet, deri më tani, këtë pjesë e kanë në posedim dhe shfrytëzim të qetë, konsiderojmë se është fituar e drejta e pronësisë me mirëbesim, konform nenit 24 al 1 të LMTHJP, (në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik), dhe nenit 40 LPTDS lidhur me nenin 291 pika 1 dhe pika 2.1 të këtij ligji. Me këtë dispozitë është paraparë se e drejta e pronësisë fitohet në bazë të lejes së ndërtimit nga organi kompetent, të cilët kanë filluar ndërtimin ose kanë ndërtuar në pronën e cila evidentohet si pronë shoqërore.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura si në përgjigje në padi, ashtu në seancat e mbajtura, kërkesëpadinë e paditësve e ka kontestuar dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Po ashtu ka theksuar, se nga të gjitha provat, të cilat gjinden në shkresat e lëndës, vërtetohet se prona në vazhdimësi ka qenë prone shoqërore, po ashtu ky faktë është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, historiat i pronës, a paditësi këtë pronë e ka vetëm në shfrytëzim, pa të drejtë tjetërsimi.

Ka theksuar se paditësit, i është ndarë, sipërfaqja prej 300m², nga njësia kadastrale 45/1, në zonën kadastrale Kaçanik, por kjo pjesë është prone shoqërore dhe me neni 29 të LMTHPJ, është paraparë se në sendin në pronësi shoqërore, e drejta e pronësisë nuk mundë të fitohet me parashkrim fitues.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike, në këtë çështje kontestimore të vërtetimit të pronësisë, gjykata me propozimin e palëve, bëri leximin e këtyre provave: dëshmi vdekja e datës 11.04.2018, aktvendimi i datës 26.12.1970, vendimi mbi dhënien e lejes ndërtimore, fleta e posedimit, kopja e planit, vendimi i datës 08.08.1973, përgjigja në padi, Historiat i parcelës dhe ekspertiza gjeodezike, pa vërejtje

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkarishtë, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, gjykata konstatojë këtë gjendje faktike.

Pjesa e njësisë kadastrale 45/1(sipas operatit të vjetër), ndërsa tani ... ZK Kaçanik(Sipas operatit të ri),është pasuri shoqërore. Paraardhësit të paditësve sipërfaqja prej 300.m² , i është dhënë në shfrytëzim në vitin 1970. Në vitin 1973, i është dhënë leja e ndërtimit, po ashtu në vitin 1973, i është lejuar ndërtimi i objektit. Paditësit janë pasardhës të ndjerit E. L..

a) Se pjesa e njësisë kadastrale 45/1,(sipas operatit të vjetër), ndërsa tani ..., ZK Kaçanik (Sipas operatit të ri), është pasuri shoqërore, këtë fakt gjykata, e ka vërtetuar nga Aktvendimin Nr.04-4306/1-70, i datës 26.12.1970, në paragrafin 1, është shënuar se E. L., nga Kaçaniku, i ndahet toka ndërtimore në shfrytëzim nga fondi i pronës shoqërore, sipas fletës posedues 379 , në sipërfaqe prej 300 m².

Po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga Historiati i njësisë kadastrale, ku është shënuar se kjo pjesë është pasuri shoqërore, nga viti 1955, e deri me datën 31.12.2019. Po ashtu edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë , është vërtetuar fakti se kjo pjesë është pasuri shoqërore.

b) se kjo pjesë i është dhënë në shfrytëzim paraardhësit të paditësit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga aktvendimi mbi dhënie të tokës ndërtimore në shfrytëzim Nr. 04-4306/1-70, i datës 26.12.1970. Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga leja ndërtimore.

c) se paditësit janë pasardhës të ndjerit E. L., këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga Dëshmi Vdekja e datës 11.04.2018, e lëshuar nga shërbimi i gjendjes civile në Komunën e Kaçanikut, ku të gjithë paditësit janë shënuar si trashëgimtarë të ndjerit E. L. , nga Kaçaniku.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, theksimeve të bëra në seancat gjyqësore, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në ligje dhe të njëjtën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar. Gjykata ka gjetur se paraardhësi i paditësve, pjesën kontestuese e ka fituar me aktvendimin e organit shtetërorë Nr. 04-4306-1/1-70, të datës 26.12.1970, pastaj është paisur me leje të ndërtimit, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar nga vendimi mbi dhënie të lejes ndërtimore, i datës 08.08.1973, pastaj nga e paditura i është lëshuar edhe kopja e planit me datën 16 maj 1972.

Gjykata paditësve jav njohu të drejtën e pronësisë në pjesë ideale, sepse paditësit pjesën e njësisë kadastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë male, i klasës 4, në sipërfaqe prej 300m², Zona Kadastrale Kaçanik, e kanë në posedim nga viti 1970, e kanë në posedim afërsisht 50 vite , të pa penguar nga askush as nga e paditura. Paraardhësi i paditësve, e pas vdekjes së tij paditësit, e kanë fituar të drejtën e pronësisë me mirë besim edhe atë konform nenit 21 dhe 24, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko pronësore, i cili ishte në fuqi në atë kohë.

Me neni 21 të këtij ligji, janë të rregulluara rastet se kur pronësia mund të fitohet sipas vetë ligjit, me këtë nen është e rregulluar se “sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzjerje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligji”.

Ndërsa me neni 24, është paraparë se personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objektin ndërtimor), në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po qe se nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë.

Me nenin 20 par.1 të LMTHJP si ligj në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike është e rregulluar se “e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”.

Ndërsa me nenin 30 par.1 ka qenë e rregulluar se “koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ec, nga ajo ditë kur mbajtësi e ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues”.

Me nenin 72 par.1 dhe 2 të LMTHJP është e rregulluar se çfarë kuptojmë me posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim, ku në bazë të kësaj dispozite “posedimi është i ligjshëm, po që

Gjykata e detyroi të paditurën qe paditësve të u a paguaj shumën prej 987,00, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore edhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 312 €, për përfaqësim në 2 seanca të mbajtura shumën nga 405.00 €, për ekspertizë të gjeodezisë shumën prej 250 €, shumën prej 20,00€, në emër të taksës për padi , të parapara sipas TA-së. Vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata e ka bazuar në dispoziten e nenit 449 lidhur me nenin 453, dhe me nenin 463 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultati i përgjithshëm i procedurës kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.2020:003361 datës 04.03.2024

Gjyqtari

Riza Livoreka

KËSHILLA JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afatë prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 26.03.2024

Paditësit 1x1

Të paditurës 1x1

Numri i lëndës: 2020:003360
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05502709